- Inkuadrimi i mëtutjeshëm integrtiv në aktivitetet e fushave tjera programore të Kryqit të Kuq të RM me përgaditje specifike kadrovike dhe metodike
- Përgaditja i një kompleti të standardizuar për diseminim (I) të cilin do ta shfrytëzojnë diseminuesit e të gjitha organizatave komunale të Kryqit të Kuq
- Zhvillimi dhe plotësimi i web-faqes, direktorium i posacëm për diseminim me informata të reja

Aktivitetet projektuese

- Organizimi i puntorive për stërvitjen e trajnuesve për diseminim me grupet specifike si nevojë e domosdoshme e zhvillimit të ardhshëm strategjik;
- Përkrahja e programeve të suksesshme dhe forcimi i sistemeve strukturore: Kryqi i Kuq në aksion-promovimi i vlerave humane (KKA-PVH) dhe Hulumtimi i të drejtës humanitare (HDH), hyrje në procesin arsimor si programe të posacme vlerësimi.

Aktivitete të rregullta/tradicionale

- Është ngrit vetëdija e popullatës për rëndësinë dhe rolin e Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe
- Është avansuar bashkëpunimi me institucionet kompetente në drejtim të diseminimit të DNH në segmente të ndryshme të jetës shoqërore
- Janë përgadit mjete metodike dhe elektronike për nevojat e diseminuesve.

Aktivitetet projektuese

- Stërvitja e trajnuesve për diseminim me grupet specifike
- Është themeluar sistem dhe procedurë për stërvitjen e trajnuesve për grupet specifike qëllimore;
- Promovimi i vlerave humane (KKA-PVH) dhe hulumtimi i të Drejtës Humanitare (HDH).

VEPRIMTARIA SHËNDETËSORE – PREVENTIVE

Avansimi i shëndetit të njeriut, mirëqenia shëndetësore dhe kujdesi për shëndetin paraqesin njërin prej menyrave themelore për zvogëlimin e goditjeve të popullatës dhe përforcimin e bashkësisë. Nëpërmjet të planifikimit dhe organizimit të aktiviteteve kualitative shëndetësore- preventive Kryqi i Kuq i RM vazhdimisht kontribon për realizimin e prioriteteve shëndetësore të përcaktuara në dokumentet strategjike.

Nëpërmjet të shënimit të begatuar të aktiviteteve tradicionale dhe aplikimit të përhershëm të aktiviteteve të reja projektuese Kryqi i Kuq i RM synon të mobilizojë të gjitha subjektet relevante që mundësojnë në mënyrë më të drejtpërdrejtë të kënaqin nevojat shëndetësore të bashkësisë. Të hapërojmë së bashku drejt shëndetit.



QËLLIMI KRYESOR

- Zvogëlimi i lëndueshmërisë së banorëve në planin shëndetësor – preventiv.

Aktivitetet e rregullta /tradicionale:

- Java e luftës kundër sëmundjeve kardiovaskulare
- Java e luftës kundër kancerit
- Dita botërore e shëndetësisë

- Dita e edukimit shëndetësor
- Java e luftës kundër tuberkulozit dhe sëmundjeve të krahavorit
- Dita botërore për luftë kundër tuberkulozit
- Java e luftës kundër sëmundjes së sheqerit
- Java e luftës kundër alkoholizmit, narkomanisë dhe duhanit
- Java e luftës kundër sidës
- Java për mbrojtjen e shëndetit të dhëmbëve

Gatishmëria e programeve për shënimin e aktiviteteve tradicionale, ligjeratave edukative të përshtatura për grupe të ndryshme qëllimore, materiale informative: broshura, pllakate, flaera, pulla postale etj.

AKTIVITETET PROJEKTUESE

- Projekti për zvogëlimin e dëmeve tek shfrytëzuesit e drogave intravenoze

Projekti, i përkrahur prej Fondacionit të Institutit shoqëria e hapur – Maqedoni dhe Federata ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe i filluar në vitin 2007 do të vazhdojë më implementin në tre organizata komunale. Ky projekt shfrytëzuesve intravenoz të drogës iu mundëson jo vetëm casje deri te mjetet sterile për injektim dhe prezervative por edhe këshillim dhe ndihmë gjatë realizimit të të drejtave të tyre sociale dhe shëndetësore. Ky projekt ndihmon intensifikimin e bashkëpunimit në mes të organizatave komunale të Kryqit të Kuq në RM dhe të gjitha subjekteve relevante në bashkësinë lokale: vetqeverisja lokale, entet shëndetësore, shkollat etj. Në këtë mënyrë bëhet mobilizimi social i bashkësisë së tërësishme për ndërmarrjen e aktiviteteve konkrete për zgjedhjen e problemeve të banorëve.

- Projektet për luftë kundër tuberkulozit

a) Kryqi i Kuq i RM ka filluar realizimin edhe me një projekt të përkrahur prej Fondit global për luftë kundër sida, tuberkulozit dhe malaries ndërsa si partnerë i Ministrisë së shëndetësisë do të vazhdojë më implementimin e projektit për luftë kundër tuberkulozit.



...është mirë të kemi aksione të këtilla. Nuk kemi kartona të kaltërt...

banorë i Fushës së Topanës

...unë jam i vetëdijshëm se kjo është me vlerë por edhe pa pagesë... nuk do të shpenzoj të holla për autobus dhe kohë duke shkuar nëpër spitale

banorë i Shuto Orizari

...tani sapo arritëm me bashkëshorten prej Hipodromit. I morëm ftesat dhe që të dy u kontrolluam. Tani presim çfarë do të ndodhë, ne nuk jemi mirë me shëndetin...

banorë i lagjes Magjari

...kjo është shumë mirë, ka shumë të papunësuar! Prej ku ne të holla për radiografi? Me këtë mund të kontrollojmë shëndetin tonë

banorë i lagjes Keramidnica

Deklarata të banorëve të nacionalitetit romë të fluorografuar në kuadër të projektit "Kryqi i Kuq në luftë kundër tuberkulozit"



Qëllimi kryesor është të ndihmohet vetqeverisja lokale, të hartojë plane strategjike në fushën e kontrollit të tuberkulozit. Këto do të kontribuojnë për një rritje të qëndrueshme të numrit të sëmurëve të zbuluar dhe përcjelljen e shkallës së shërimit të tyre.

Projekti zhvillohet në tre vetqeverisje lokale duke shfrytëzuar metodologjinë e projektit “Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë”. Në këtë mënyrë Kryqi i Kuq është fasilitator në procesin e sjelljes së planeve lokale si dhe në afrimin dhe pasqyrimin e nevojave të popullatës në këto plane.

b) Organizatat komunale të Kryqit të Kuq në bashkëpunim me DAT lokale (dispanzeret anti tuberkuloze) realizojnë aktivitete për promovimin e trajtimit anti tuberkuloz gjegjësisht mundësitë për shërimin e TBC në mjediset e tyre. Si grup qëllimor për këto aktivitete janë zgjedhur banorë të mjediseve rurale, hapësira ku qarkullimi i informatave të karakterit shëndetësor – preventiv është shumë i dobët.

■ Kujdesi paliativ dhe trajtimi shtëpiak

Kryqi i Kuq i RM inicon aktualizimin e nevojës për kujdes paliativ dhe trajtim shtëpiak të grupeve të ndryshme qëllimore (të moshuar, të lënduar, të sëmurë).

Në korelacion me njohuritë dhe përvojat më të reja botërore për inkuadrimin e vullnetarëve për sigurimin e kujdesit paliativ në bashkësi Kryqi i Kuq do të fillojë me sigurimin e resurseve për zbatimin e aktiviteteve projektuese konkrete.

REZULTATET E PRITURA

Aktivitetet e rregullta:

- Është rrit kapaciteti i shoqatës kombëtarë për t’iu përgjigjur nevojave të caktuara të popullatës së goditur për zbutjen e problemeve shëndetësore me të cilat ballafaqohen si dhe të nevojave të caktuara të institucioneve të shtetit, natyrisht si partner.
- Ngritja e vetëdijes së përgjithshme të opinionit për problemet shëndetësore tek popullata e goditur për sigurimin e ndihmës dhe kujdesit aktiv.

AKTIVITETET PROJEKTUESE:

■ Projekti për zvogëlimin e dëmeve tek shfrytëzuesit intravenoz të drogave

1. Shfrytëzuesit intravenoz të drogave kanë casje deri te mjetet sterile për injektim që zvogëlon dëmin nga përhapja e shpejtë e sëmundjeve infektive.
2. Programi “Zvogëlimi i dëmeve” është përkrahur prej opinionit më të gjërë.
3. Kryqi i Kuq ka informata për ndodhitë me shfrytëzimin e drogave dhe sipas kësaj vepron sipas nevojave konkrete.

■ Projekti për luftë kundër tuberkulozit

1. Është rritur zbulimi i të sëmurëve prej tuberkulozit dhe shkalla e shërimit të tyre.
2. Janë aprovuar planet për kontrollë të tuberkulozit
3. Janë zgjeruar aktivitetet për luftë kundër tuberkulozit te organizatat e reja të Kryqit të Kuq në RM.

■ Kujdesi paliativ dhe trajtimi shtëpiak

1. Është rritur vetëdija e opinionit për nevojën e sigurimit të kujdesit paliativ dhe kujdesit në kushte shtëpiake..
2. Janë siguruar resurse të nevojshme dhe parakushte për realizimin e aktiviteteve konkrete projektuese

DHURIMI I GJAKUT



“një gjë e kam të sigurtë: të vetmit në mes ne të rinjve që do të jenë të lumtur janë ata të cilët do të kërkojnë dhe gjejnë mënyrën që t’iu dhurojnë dicka të tjerëve.”

Deklaratë e një dhuruesi të ri të gjakut



Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë po krijon një model të ri të komunikimit social dhe qytetarë i cili është informativ, edukativ, etik dhe i bazuar në njohuritë shkencore. Nëpërmjet të këtij modeli në mënyrë permanente duhet vepruar tek qytetarët për respektimin e parimeve të dhurimit të gjakut dhe rëndësinë e tij për nevojat për gjak të mirë dhe të sigurtë dhe për kujdes maksimal për shëndetin e dhuruesve.

Kryqi i Kuq i RM edhe në të ardhmen do të respektojë marrëveshjen për bashkëpunim në mes të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe Organizatës botërore të shëndetësisë (maj 2005).

Promovimi i dhurimit vullnetarë përfshin të gjithë pjesëmarrësit në procesin e dhurimit të gjakut me qëllim që të arrihen qëllimet e parapara me Programin për organizimin dhe avansimin e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë.

QËLLIMI KRYESOR

Aplikimi i formave të reja motivuese dhe ngritja e vetëdijes e grupeve të ndryshme qëllimore.

AKTIVITETET:

- Shënimi i 17 marsit 2008- Dita e dhurimit të gjakut në Republikën e Maqedonisë
- Shënimi i 14 qershorit 2008- Dita botërore e dhurimit të gjakut
- Në pajtim me Ligjin për siguri gjatë furnizimit me gjak, përgaditja e materialeve shëndetësore-edukative, propaganduese dhe mjeteve motivuese për dhuruesit e gjakut,

zbatimi i anketave, ligjeratave dhe kampanjave me grupe të caktuara qëllimore si dhe

organizimi i aksioneve për dhurimin e gjakut në bazë të planit vjetor.

- Përpunimi i një strategjie të posacme për organizimin e aksioneve për dhurimin e gjakut me grupe të ndryshme qëllimore
- Organizimi i seminareve dhe puntorive për edukim të motivuesve për dhurim vullnetarë të gjakut
- Promovimi i modelit të ri për dhurim vullnetarë me qëllim zbatimin e strategjisë edukative për ndryshimin e traditës dhe kulturës për dhurimin e gjakut në raport me të drejtat e dhuruesve si privilegj dhe përgjegjësi konform obligimeve për sigurimin e gjakut të sigurt.
- Gjetja e përmbajtjeve dhe formave të reja të aktiviteteve për organizimin e aksioneve për dhurimin e gjakut në sektorin privat.
- Organizimi i kampanjave dhe aksioneve për dhurimin e gjakut më studentë të të gjitha univerziteteve shtetërore dhe private në Republikën e Maqedonisë
- Bashkëpunim i përhershëm me mjetet e informimit publik dhe prania më e madhe me forma të ndryshme lidhur me dhurimin e gjakut.
- Organizimi i aksioneve të jashtëzakonshme sidomos gjatë verës në rast të mungesës së gjakut
- Puna e Klubit të dhuruesve të gjakut
- Formimi i klubeve të dhuruesve të rinj me qëllim rritjen e numrit të dhuruesve të rinj dhe ofrimi i tyre i përhershëm dhe krijimi i rrjetit të të rinjve të obliguar për promovimin dhe motivimin e dhuruesve të rinj nëpër institucionet arsimore
- Bashkëpunimi me SHN nga fqinjësia dhe SHN tjera për këmbimin e përvojave në planin e dhurimit të gjakut

REZULTATET E PRITURA:

- Është përmirësuar informimi i qytetarëve për tejkalimin e stigmës, paragjytimeve, dhurimi i sigurt ose qëndrimi injorant ndaj dhurimit të gjakut
- Është rritur numri i dhuruesve vullnetarë të gjakut dhe është rrit vetëdija e nje rrezve nëpër bashkësi të ndryshme dhe grupe qëllimore
- Është përmirësuar vetëdija për dhurim vullnetarë të gjakut në pajtim me konceptin e ri
- Është rritur numri i motivuesve të edukuar që në mënyrë aktive janë inkuadruar në procesin e organizimit të aksioneve për dhurimin vullnetarë të gjakut në mjediset e tyre
- Është rritur numri i vullnetarëve të rinj



NDIHMJA E PARË

Ndihma e Parë paraqet njërën prej aktiviteteve më të njohura të Kryqit të Kuq në RM me të cilën ai kontribon që individët, familjet dhe bashkësitë në mënyrë të suksesshme pengojnë ose zbutin pasojat nga fatkeqësitë, lëndimet ose sëmundjet.

Ndihma e Parë është akt i humanitetit, i thjeshtë dhe gjest vullnetarë që ka fuqi të mobilizojë individët dhe bashkësitë për mbrojtjen dhe ruajtjen e jetës.

Kryqi i Kuq i RM në vazhdimësi punon për aktualizimin e Ndhmës së Parë me theks të vecantë tek implikimet pozitive që ajo i ka në jetën e përditshme, në kushte të katastrofave për parandalimin e sëmundjeve dhe sidomos për promovimin e shëndetit dhe sjelljeve të sigurta të anëtarëve në bashkësi.

Ofrim vullnetarë, me kohë dhe i shkathët i Ndhmës së Parë pa kurrfarë diskriminimi!

QËLLIMI KRYESOR

Zvogëlimi i lëndueshmërisë së popullatës nëpërmjet të edukimit kualitativ për Ndhmë të Parë



AKTIVITETET E RREGULLTA

- Shënimi i Ditës botërore të Ndhmës së Parë
- Mësim me kurse për Ndhmën e Parë për kandidatë për shoferë të automjeteve
- Mësim me kurse për Ndhmën e Parë për organizata punuese dhe grupe specifike qëllimore
- Organizimi i garave shtetërore nga Ndhma e Parë
- Intensifikimi i bashkëpunimit me institucione dhe organizata relevante
- Veprim i vazhdueshëm në fushën e sigurimit në komunikacion nëpërmjet të ndërtimit të lidhjeve operative në nivel lokal dhe kombëtarë (pjesëmarrja aktive në Komisionin kombëtarë për siguri në komunikacion)

...Kam mundësi të mësoj si t'i ndihmoj tjetrit...Faleminderit!

këtë mundësi do ta shfrytëzoj

vullnetarë i KCRM

...Do të ishte shumë mirë të kemi mundësi cdo ditë të shoqërohemi, të ushtrojmë dhe të tregojmë sa njohuri kemi për Ndhmën e Parë. Mendoj se ne fëmijë më mirë e njohim Ndhmën e Parë se të rriturit. Vetëm na duhet hapësirë që këtë të kemi mundësi t'ua tregojmë. Edhe ata mund të mësojnë mund të mësojnë dicka prej nesh...

më i ri në garat e Ndhmës së Parë, vullnetarë i KCRM

AKTIVITETET PROJEKTUESE

- Formimi i rrjetit për Ndhmën e Parë
- Formimi i rrjetit për punë intenzive në mes të organizatave komunale të Kryqit të Kuq në fushën e Ndhmës së Parë që do të mundësojë bashkimin e përvojave, njohurive dhe aktiviteteve në këtë fushë.
- Formimi i shërbimeve sanitare shkollore
- Organizimi i nxënësve nëpër mjediset e tyre shkollore nëpër shërbimet e sanitetit ku do të mësojnë, stërviten dhe aplikojnë njohuritë nga Ndhma e Parë

REZULTATET E PRITURA:

- Është përforcuar shpirti vullnetarë dhe solidariteti tek

kuadrot e stërvitura të Kryqit të Kuq në RM dhe popullata për ofrimin e Ndhmës së Parë në mënyrë vullnetare dhe pa diskriminim

- Është rritur kualiteti në edukim nga Ndhma e Parë me

harmonizimin e përmbajtjeve dhe standardeve të Ndhmës së Parë dhe është ndërtuar sistem kualitativ për edukimin e kuadrove nga organizatat komunale për Ndhmë të Parë me aplikimin e moduleve të reja për edukim të grupeve të ndryshme qëllimore të dëgjuesve

- Është rritur vetëdija tek pjesëmarrësit në komunikacion

se si njohuritë nga Ndhma e Parë mundësojnë siguri më të madhe në rrugë.

- Është intensifikuar bashkëpunimi i ndërsjellë në organizatat komunale të Kryqit të Kuq në RM në fushën e Ndhmës së Parë nëpërmjet të këmbimit të informatave, njohurive, organizimi i aktiviteteve të përbashkëta.

- Është rritur promovimi i Ndhmës së Parë në mjediset



VEPRIMTARIA SOCIALE – HUMANITARE



Veprimtaria sociale humanitare e Kryqit të Kuq në RM përfshin një spektër të gjërë të aktiviteteve të karakterit humanitarë që kanë për qëllim përkrahjen dhe ndihmën populatës së goditur si dhe aktivitetet për preventivë të popullatës që ballafaqohet me situata të ndryshme të rrezikshme

Zhvillimi dhe avansimi i metodës për vlerësim të shpejtë të përbashkët të nevojave dhe përkrahja për zgjedhjen e problemeve prioritare të bashkësive të goditura njëkohësisht do të shërbejë për ndërtimin e strategjisë për përforcimin e kapaciteteve dhe zvoqimin e lëndueshmërisë së popullatës nëpër bashkësi me ndihmën e vetqeverisjes lokale, institucioneve tjera relevante, sektorin joqeveritarë dhe donatorët potencial.

QËLLIMI KRYESOR

Zvogëlimi i lëndueshmërisë së popullatës

AKTIVITETET:

AKTIVITETET TRADICIONALE / TË RREGULLTA

- Java e solidaritetit
- Dita e solidaritetit
- Java e kujdesit për të moshuarit
- Në kuadër të javës së solidaritetit, organizohet Aksion grumbullues të mirave materiale (ushqim, veshmbathje etj si dhe të holla) për ndihmë të personave më të goditur.
- Përgaditja e programeve për shënimin e aktiviteteve tradicionale, ligjeratave edukative dedikuar të rinjve në institucionet edukativo-arsimore, broshura si dhe materialet informative – edukative: pllakate, fllaera.
- Organizimi i kampanjës për shënimin e 16 tetorit “Dita e urisë” me qëllim të sigurimit të mjeteve financiare dhe artikujve ushqimorë për ndihmë personave që janë në situatë të rëndë materiale.
- Përgaditja e programeve, projekteve për sigurimin e donacioneve për ndihmë materiale për kategoritë e goditura të popullatës me theks tek ndihma dhe përkrahja e personave me nevoja të posacme si dhe ndihma për institucionet e caktuara që kanë nevojë për ndihmë të këtyllë.
- Bashkëpunimi me institucionet dhe organizatat relevante.

AKTIVITETET PROJEKTUESE

- Projekti: “Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë”
- Organizimi i tre seminareve për edukimin e ekipeve SHPB për vlerësim të shpejtë të përbashkët për nevojat e personave të goditur të bashkësisë
- Organizimi i tre puntorive në grup më të madh për përcaktimin e nevojave të personave të goditur në bashkësi
- Implementimi i tre mikro projekteve për realizimin e nevojave të bashkësisë së goditur rrome në bashkësi

Përkrahja dhe ndihma psiko sociale

- Organizimi i tre seminareve tre ditore me përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për trajnimin e edukatorëve për ofrimin e Ndhmës së Parë psikologjike
- Shtypja e një Doracakut për Ndhëm e Parë psikologjike në gjuhën maqedone dhe shqipe
- Organizimi i puntorive edukative për përhapjen e njohurive për ofrimin e Ndhmës së Parë psikologjike dhe përkrahjen e mjediseve komunale



...Fëmijët janë marrë prej rrugës dhe kohën e kalojnë mirë, ata kanë ndryshuar shumë në sjelljet e tyre, me padurim presin kohën kur duhet të shkojnë në puntori që i organizon Kryqi i Kuq në bazë të projektit “Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë”.

Prindër të bashkësisë “Bashkimi” – Kriva Pallankë)

- Pjesëmarrje aktive në rrjetin europian të bashkëpunimit të SHK të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe për implementimin e aktiviteteve për përkrahje psikologjike

Lufta kundër trafikimit me njerëz

- Organizimi i Puntorisë për edukimin e të punësuarve dhe vullnetarëve nëpër organizatat komunale të Kryqit të Kuq të RM për implementimin e aktiviteteve në luftën kundër tregtimit me njerëz
- Organizimi i tre seminareve treditore me të rinjtë e organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për edukim të grup moshave të edukatorëve me qëllim të edukimit të mëtutjeshëm në mes të rinjve për ngritjen e vetëdijes për mbrojtje nga trafikimi me njerëz.
- Përgaditja e një doracaku për edukim të grupmoshave dhe materiale informativo-edukative.
- Bashkëpunimi me institucione qeveritare, organizata joqeveritare dhe ndërkombëtare të cilat veprojnë në planin e luftës kundër trafikimit të njerëzve
- Pjesëmarrja aktive në rrjetin europian për bashkëpunim në mes të SHN të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në luftën kundër trafikimit me njerëz.

REZULTATET E PRITURA:

Традиционални/редовни активности

- Aktivitetet tradicionale/të rregullta
- Është rritur kapaciteti i shoqatës kombëtare për t'u përgjigjur nevojave të caktuara të popullatës së goditur për zbutjen e problemeve sociale me të cilat ballafaqohemi.
- Është siguruar përkrahja dhe janë plotësuar disa nevoja të institucioneve të caktuara të shtetit
- Është ngrit opinionin e përgjithshëm për problemet me varfëri si dhe vetëdija e popullatës për ndihmën e nevojitur dhe kujdesin e popullatës.

AKTIVITETET PROJEKTUESE:

- Projekti: "Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë"
- Është rritur kapaciteti i organizatave komunale në RM për aplikimin e metodës për vlerësim të shpejtë të përbashkët të nevojave të personave të goditur të bashkësisë.



“Këta fëmijë nuk kanë kushte për të mësuar mësuar nëpër shtëpitë e tyre, nuk kanë hapësirë adekuate dhe nuk ka kush t’iu ndihmojë gjatë mësimit sepse prindërit e tyre janë analfabetë ose me shkollim të pamjaftueshëm, gjenden në pozitë të keqe ekonomike dhe janë të papunësuar. Projekti ofron mundësi këta fëmijë të fitojnë ndihmën e nevojshme dhe përkrahjen e domosdoshme për përvetësimin dhe mësimin e materialeve të reja nga gjuha angleze si dhe identifikimin me shembujt pozitiv që iu japin mësim dhe këshilla për nevojën e arsimimit si një prej faktorëve më të rëndësishëm për zhvillimin e tyre intelektual, moral dhe kulturor.

(arsimtarë i shkollës fillore i inkuadruar në projektin: Zhvillimi i përbashkët i bashkësisë, “Mahalla”, Valandovë).].



- Tre bashkësi janë ndihmuar për t’u ballafaquar me një prej nevojave prioritare të popullatës së goditur rrome.

Përkrahja dhe ndihma psiko – sociale

- Janë edukuar 18 edukatorë prej organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për implementimin e aktiviteteve për Ndhmën e Parë psikologjike.
- Janë aprovuar shkathtësi për përforcimin e popullatës për t’u ballafaquar me trauma, strese dhe plotësim të nevojave elementare
- Janë fituar përvoja prej shoqatave tjera kombëtare që realizojnë programe për përkrahje psikologjike
- Lufta kundër trafikimit me njerëz
- Janë edukuar 12 implementues të organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për realizimin e aktiviteteve preventive për luftë kundër trafikimit me njerëz
- Janë edukuar 48 të rinj prej 12 organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për

GATISHMËRI DHE VEPRIM GJATË KATASTROFAVE



Aktivitetet në planin e gatishmërisë dhe veprimit në rast të katastrofave gjatë vitit 2008 do të drejtohen nga implementimi i Strategjisë 2008-2010 dhe kjo është rezultat i aktiviteteve të realizuara deri më tani dhe parashikimeve të planit zhvillimor të Kryqit të Kuq të RM 2006-2010.

Janë marrë parasysh edhe treguesit e vlerësimit dhe analizës së kryer të aktiviteteve të organizatave komunale të Kryqit të Kuq sipas veprimtarive.

Janë marrë parasysh edhe marrëveshjet bilaterale të shoqatës sonë kombëtare me shoqatat tjera kombëtare si dhe Strategjia e Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe 2000-2010 si dhe plani i aktiviteteve të Delegacionit regional të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në Budapest në pjesën për menaxhim me katastrofat.

QËLLIMI KRYESOR

Gatishmëria për veprim të shpejtë dhe efikas në rast të katastrofave.

AKTIVITETET:

- Organizimi i dy trajnimeve për freskimin e njohurive të Njesisë së Kryqit të Kuq të RM për gatishmëri gjatë katastrofave
- Ushtrim rajonal me të gjitha Njësitë për gatishmëri gjatë katastrofave (NJGK) të Kryqit të Kuq me pjesëmarrje të Qendrës për menaxhim me kriza, Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, ARM, policisë, enteve mjeksore etj.
- Një seminar trajnues për rolin e shëndetësisë gjatë katastrofave me vullnetarë – anëtarë të NJGK.
- Një seminar trajnues për freskimin e njohurive të ekipit për ujë dhe sanitet dhe kurs të avansuar për prodhim më të madh të ujit.
- Bashkëpunimi dhe shtypja e doracakut për montimin dhe shërbimin e stacionit të ujit në rast të katastrofave.
- Edukimi i instruktorëve për siguri në ujë dhe male.
- Ushtrim simulativ regjional me pjesëmarrës nga shtetet e Ballkanit (për vullnetarë që kanë kryer kurs për ujë dhe sanitet)
- Përgaditja e strategjisë për zvogëlimin e rreziqeve të mundshme prej ndryshimeve klimatike.
- Inkorporimi i Njesisë për gatishmëri gjatë katastrofave të Kryqit të Kuq në RM në sistemin e shtetit.
- Ndërmarrja e aktiviteteve për casje të data bazës në rrugë elektronike.
- Organizimi i seminarit trajnues për 34 përfaqësues të organizatave komunale të Kryqit të Kuq që do të stërviten për punë me data bazë.
- Vlerësimi nga rreziqe të mundshme nga katastrofat në RM.



“Në një moment stihia e zjarrit e rrethoi veturën e Kryqit të Kuq pran-daj ishim të detyruar më gjatë nëpër rrugicat malore të ikim prej qarkut të zjar-rit që për mua ishte një përvojë e re”,

deklaroi një anëtarë i Njesisë për gatishmëri gjatë katastrofave që mernte pjesë në aksion në të cilin shpërndau ujë për pije dhe ofrohej Ndihma e Parë për njerëzit që fikin zjarrin në rajonin e Katllanovës.

REZULTATET E PRITURA:

- Janë aftësuar anëtarët e Njesisë për gatishmëri gjatë katastrofave të Kryqit të Kuq të RM për veprim gjatë katastrofave.
- Është përmirësuar koordinimi dhe komunikimi i Njësive për gatishmëri gjatë katastrofave të Organizatave komunale të Kryqit të Kuq, në mes veti si dhe me institucionet shtetërore në rast të katastrofave.
- Janë aftësuar vullnetarë dhe të punësuar për shërbime mjeksore në rast të katastrofave
- Janë freskuar njohuritë e ekipeve ekzistuese për ujë dhe sanitet dhe janë rrit kapacitetet për prodhimin e ujit.
- Doracak për shfrytëzimin e statcionit të ujit
- Është fituar kuadër instruktorësh adekuat për shpëtim në ujë dhe male.
- Është përmirësuar bashkëpunimi rajonal për veprim gjatë katastrofave në rajon me theks mbi plotësimin e nevojave për ujë dhe sanitet
- Është hartuar strategji për edukim të shoqatës kombëtare, institucionet dhe opi-nionin më të gjërë për mbrojtje prej ndryshimeve klimatike.
- Është përmirësuar bashkëpunimi me Qendrën për menaxhim me krizat dhe Drejtorinë për mbrojtje dhe shpëtim.
- Data baza ekzistuese është adaptuar për shfrytëzim në rrugë elektronike.
- Është kryer edukimi i kuadrit profesional dhe vullnetarë në organizatat komunale të Kryqit të Kuq për shfrytëzim dhe sendërtim të data bazës.



SHËRBIMI PËR KËRKIM

Puna e shërbimit për kërkim gjatë vitit të kaluar u karakterizua me intenzitet të zvogëluar të punës. Kjo në Shërbim do të thotë periudhë në të cilën vuajtjet njerëzore si rezultat i luftës ose katastrofave njerëzore u sollën në minimum. Megjithatë gjithmonë mbeten fate të pazgjidhura të njerëzve.

Duke theksuar përvojën dhe kontinuitetin e aktiviteteve të Shërbimit për kërkim është e pranishme vetëdija dhe vullneti për çasje të mëtutjeshme strategjik dhe zhvillim të kapacitetit vetjak dhe raporteve të partneritetit.

AKTIVITETET :

- Vlerësimi i nevojave për transformim të Shërbimit për kërkim në Byro kombëtare për informata.
- Bashkëpunimi me KNKK është aktivitet i cili këtë vit do të drejtohet kah përkrahja për realizimin e qëllimeve programore dhe strategjike.
- Ndërtimi i raportit adekuat me qeverinë dhe institucionet qeveritare për realizimin e obligimeve informative ndaj viktimave të katastrofave të natyrës dhe katastrofave të shkaktuara prej njeriut.
- Revidimi i aktiviteteve të Shërbimit për kërkim të Kryqit të Kuq në RM me qëllim inkuadrimit e kategorive të reja të grupeve qëllimore të planifikuara të përfshihen në zhvillimin e ardhshëm (emigrantë ilegal dhe viktimë të trafikimit me njerëz).
- Organizimi i puntorive trajnuese për vullnetarët e stërvitur dhe të punësuarit profesional nëpër organizatat komunale të Kryqit të Kuq për punë në shërbimin për kërkim.

REZULTATET E PRITURA:

- Kapacitetet e përmirësuara në Kryqin e Kuq të Republikës së Maqedonisë për

Ishte e madhe brenga e babait i cili tani më dy vitë nuk kishte kurrfarë informata për bijën e tij e cila gjatë kohë jeton me familjen e saj në Australi. U realizuan kontakte me Kryqin e Kuq australian dhe shërbimin e tyre për kërkim. Raportet e larta profesionale të kolegëve nga Kryqi i Kuq australian për një kohë të shkurtë dhanë frytet e veta. Familja sërish komunikonte. Kjo ishte një gëzim dhe mirënjohje pa kufinj.

Shërbimi për kërkim e realizoi misionin e vet human.

TË RINJTË E KRYQIT TË KUQ

Të rinjtë kanë vendin qendror në Lëvizjen e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënën e Kuqe. Në më shumë shoqata kombëtare, numri më i madh i vullnetarëve që e përbëjnë boshtin e kësaj organizate janë njerëz të rinj si bartës të iniciativave për ndryshime dhe progres.

Gjatë plotësimit të nevojave shoqërore të rinjtë njëkohësisht kanë rol të rëndësishëm si vullnetarë por edhe si grup e rëndësishme qëllimore.

Të rinjtë e Kryqit të Kuq të RM po fusin një çasje të re, forma të reja të organizimit, fusha të reja të veprimit, lidhin bashkëpunime të reja në nivel lokal dhe ndërkombëtarë, gjegjësisht aplikojnë ndryshime dhe risi masovike. Me rritjen e kapaciteteve rriten edhe sfidat ndaj të cilave të rinjtë e Kryqit të Kuq të RM do përgjigjen me gatishmëri dhe edhe një herë do ta arsyetojnë besimin e shprehur dhe epitetin e fuqisë lëvizëse të shoqatës kombëtare.



“ Deri tani disa herë kam marrë pjesë në gara të Ndhmës së Parë dhe sinçerisht u befasova kur pashë loja të reja dhe vende pune. Ato të mëparshmet, jo se nuk ishin interesante por ...çdo vit gjëra të njejta. Më në fund – dicka më e gjallë dhe më argëtuese...”

pjesëmarrës në garat shtetërore të Ndhmës së Parë

AKTIVITETET :

- **Sendërtimi i formave të reja të organizimit të vullnetarëve të rinj nëpërmjet të formimit të klubeve në organizatat komunale të Kryqit të Kuq në RM.**

Si trend modern në kuadër të organizimit të vullnetarëve dhe me qëllim të përmirësimit të kualitetit gjatë ofrimit të shërbimeve të organizatës do të angazhohemi për krijimin e formave më të organizuara të veprimit të të rinjve nëpërmjet të formimit të klubeve. Në disa organizata komunale të Kryqit të Kuq në RM, sidomos pas përfundimit të KKA-PVH gjatë viteve 2006-2007 u formuan klube të të rinjve të cilat gjatë vitit treguan kreativitet të madh, produktivitet dhe kualitet. Nëpërmjet të kësaj forme të veprimit si dhe çasjes për njohjen e nevojave, vullnetarët e rinj do të mundën në masë të madhe të përforcojnë imazhin, të risin numrin dhe kualitetin gjatë ofrimit të shërbimeve popullatës së goditur në mjediset e tyre.

- **Krijimi i rrjetit të koordinatorëve të rinj**

Gjatë vitit të kaluar u fillua një model i ri i organizimit të aktiviteteve të të rinjve nëpërmjet të aplikimit të koordinatorëve të rinj nëpër organizatat komunale të Kryqit të Kuq. Angazhimi i koordinatorëve të rinj nëpër organizatat komunale të Kryqit të Kuq do të rrit pasqyrimin e gjithmbarshëm të organizimit, numrin e madh të aktiviteteve si dhe çasjen tek partnerët dhe donatorët potencial.

- **Këmbimi i përvojave me organizatat studentore dhe univerzitetet në RM**

Është prezent fakti se pas mbarimit të shkollimit të mesëm një pjesë e madhe e të rinjve e lëshojnë vendbanimin e tyre dhe shkojnë në studime në ndonjërin prej qyteteve ku janë institucionet e larta arsimore. Këta të rinj në vete bartin potencial i cili mund të kontribuojë për përforsim të theksuar të kapaciteteve të të rinjve të Kryqit të Kuq nëpërmjet të një çasjeje deri te grupet e caktuara qëllimore dhe ofrimi i shërbimeve.

Prioritet i punës së kësaj popullate të re do të jetë ngritja e vetëdijes për dhurimin e gjakut dhe promovimin e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare në mënyrë të organizuar me qëllim të krijimit të bërthamave të vullnetarëve në institucionet e larta arsimore.

- **Zgjerimi ndërkombëtarë i programeve dhe projekteve në rajon**

Në kuadër të aktiviteteve ndërkombëtare të rinjtë edhe më tutje do të angazhohen në mënyrë sa më të suksesshme të prezentojnë shoqatën kombëtare nëpërmjet të pjesëmarrjes në më shumë seminare të të rinjve, puntori, kampe, konferenca etj. Në këtë fushë



“Kryqi i Kuq organizon edhe aktivitetet të këtitilla? Deri tani kam menduar se është vetëm dhurimi i gjakut dhe ndarja e veshmbathjeve të vjetra...por edhe kur hyra në provim për patent shoferin dhe Ndhimë të Parë. Nuk e kam ditur se edhe ju organizoni aktivitete me të rinjtë nga fusha e veprimit gjatë katastrofave dhe e Drejta Ndërkombëtare Humanitare.

Pjesëmarrës në një ngjarje muzikore promovuese me rastin e “Javës së Kryqit të Kuq”

theks sidomos do të bie në pjesëmarrjen e botimit të II të Projektit ndërkombëtarë të të rinjve “Miqësi pa kufinj”, organizimin e kampit veror të të rinjve të Maqedonisë si dhe pjesëmarrjen në “Mbledhjen europiane për bashkëpunim të të rinjve të Kryqit të Kuq – Kroaci 2008.

■ Aktivitetet dhe kampanjat tradicionale

Vullnetarët e rinj të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe janë bartës të rreth 80% të aktiviteteve në teren. Këto të dhëna dëshmojnë edhe me punën e deritanishme të të rinjve të Kryqit të Kuq në RM me tendencë edhe me tutje të vazhdojnë të marrin pjesë aktive në kuadër të veprimit të shoqatës kombëtare.

Aktivitetet kryesore të të rinjve gjatë vitit 2008 do të lidhen me kalendarin tradicional të aktiviteteve të Kryqit të Kuq të RM të përcjellura me theks më të madh tek aksioni sportiv – humanitar “Për fëmijëri më të lumtur”, garat nga Ndhimë e Parë si dhe aktivitetet me rastin e 5 dhjetorit “Dita botërore e vullnetarizmit”.

REZULTATET E PRITURA

Vullnetarët e rinj i realizojnë aktivitetet e tyre nëpërmjet të formave të organizuara të veprimit në formë të klubeve në organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

Numri i koordinatorëve të rinj të angazhuar në organizatat komunale të Kryqit të Kuq është rritur dyfish në raport me vitin 2007.

Në kuadër të dy univerziteteve me sukses realizohen programet për promovimin e DNH dhe është ngritur vetëdija për dhurim vullnetarë të gjakut.

Është realizuar me sukses kampi ndërkombëtarë veror i të rinjve dhe është zbatuar një këmbim studimor i përvojave me të rinjtë e shoqatës kombëtare që vepron në rajon.

Organizatrat komunale kanë së paku nga dy vullnetarë të trajnuar për organizimin dhe zhvillimin e kapaciteteve vetjake.

Aksioni sportiv – humanitar dhe rekreativ “Për fëmijëri më të lumtur” është realizuar me sukses në organizatat komunale të Kryqit të Kuq.

Të rinjtë në organizatat komunale të Kryqit të Kuq zbatojnë kampanja lokale për promovimin e vullnetarizmit.

INFORMIMI DHE KOMUNIKIMET

Informimi dhe komunikimet duhet të shikohen si element qenësor për ndërtimin e kapaciteteve dhe duhet të shikohet nevoja për çasje të përbashkët për promovimin e aksioneve dhe vlerave të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë në mënyrë konkurente dhe profesionale. Informimi si mjet për komunikim është i korporuar në punën e shoqatës kombëtare nëpërmjet të së cilës arrihen shkathtësi dhe njohuri që qojnë kah përforcimi i imazhit të organizatës.

QËLLIMI KRYESOR

Përforcimi i imazhit të shoqatës kombëtare

AKTIVITETET :

- Promovimi i komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm i Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.
- Botimi i revistës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë “Meridianet humane”
- Përgaditja dhe distribuimi elektronik i revistës – e i Kryqit të Kuq të RM
- Mirëmbajtja dhe sendërtimi me përmbajtje të reja i ëeb faqes së Kryqit të Kuq të RM



“Ju faleminderit për informatat për aktivitetet Tuaja të realizuara të cilat rregullisht i dërgoni në e mail adresën time. Dëshiroj që edhe më tutje të pranoj revistën Tuaj elektronike”

Kjo është një prej porosive që arrijën qysh prej numrit të parë të E- revistës së Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë. Këtë vit e rrumbullaksum me 60 numra të revistës elektronike që rregullisht u dërguan në 40 mijë e mail adresa. Sipas deklaratave të lexuesve tanë ky lloj i komunikimit me opinionin u tregua me të vërtetë i suksesshëm. Aktivitetet në këtë plan edhe më tutje do të vazhdojnë.

- Përshtatja e konceptit për mobilizimin e fondeve në veprimtarinë botuese të Kryqit të Kuq të RM.
- Nxitja e organizatave komunale të Kryqit të Kuq për zhvillimin e veprimtarisë botuese në mjediset e tyre.
- Bashkëpunimi me mjetet e informimit publik për promovimin e aktiviteteve dhe punës së Kryqit të Kuq të RM.
- Organizimi i seminareve me gazetarë.
- Zbatimi i hulumtimit të opinionit publik për imazhin e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë.

REZULTATET E PRITURA

- Janë arritur rezultate më të mira për avansimin e komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm në shoqatën kombëtare.
- Janë futur përmbajtje të reja në konceptin e revistës së Kryqit të Kuq të RM “Meridianet humane”.
- Opinioni përherë është informuar për të gjitha aktivitetet e realizuara të Kryqit të Kuq të RM me ç’rast janë shfrytëzuar të gjitha mjetet bashkëkohore të komunikimit me mjetet e informimit publik.
- Janë arrit rezultate në zhvillimin e veprimtarisë botuese në organizatat komunale të Kryqit të Kuq.



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTARË

Bashkëpunimi i vazhdueshëm i partneritetit të Kryqit të Kuq të RM me komponentët e Lëvizjes, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe kombëtare, kompanitë dhe partnerët tjerë në vend dhe jashtë, paraqet sfidë të përhershme për angazhimet për sigurimin e përkrahjes programore dhe projektuese për ndihmë kategorive të goditura të popullatës në RM dhe më gjërë. Aktivitetet ndërkombëtare mundësojnë paraqitje më të mirë të aktiviteteve të shoqatës kombëtare në planin ndërkombëtarë, këmbimin e përvojave, fitimin e njohurive të reja, prezentimin e të arriturave dhe edukimin e resurseve kadrovike të organizatës.

QËLLIMI KRYESOR

Ndërtimi i raporteve të partneritetit dhe bashkëpunimit.

AKTIVITETET

- Koordinimi i projekteve të finansuara prej fondeve për sendërtimin e kapaciteteve të Kryqit të Kuq norvegjez, Komitetit ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq, Fondit për sendërtim intenziv të kapaciteteve të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe shoqata e organizata tjera kombëtare.
- Bashkëpunim i vazhdueshëm me misionin e Komitetit ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq në Shkup.
- Bashkëpunim me Sekretariatit në Gjyrenevë dhe Zonën europiane të Federatës ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në Budapest.
- Avansimi i bashkëpunimit bilateral me shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.
- Nxitja e organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM për lidhjen e bashkëpunimit bilateral me organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nga SHN tjera me të cilat Kryqi i Kuq i RM ka nënshkruar kontrata.
- Komunikimet dhe ndërtimi i raporteve të partneritetit për sigurimin e projekteve për përkrahje humanitare për kategoritë e goditura të popullatës me organizatat partnere ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare.
- Tërhykja e donatorëve të rinj për sigurimin e mjeteve për projekte humanitare
- Koordinimi dhe organizimi i pjesëmarrjes së përfaqësuesve të SHN tonë në kurse të specializuara, gara, seminare, konferenca dhe kongrese në shtetet e jashtme.
- Përgaditja dhe koordinimi i personave profesional për pjesëmarrje në misione humanitare jashtë vendit.



“Kisha njohuri paraprake se Kryqi i Kuq i RM është shoqatë kombëtare e mirë dhe me këtë ngjarje u dëshmuar këto fakte. Kryqi i Kuq i RM është shoqatë kombëtare e organizuar më së miri me të cilën deri më tani kam pas mundësi të vëjë kontakt. Jam i impresionuar nga transparenca, çiltërsia si dhe nga dëshira dhe gatishmëria e Kryqit të Kuq të RM për veprim. KK norvegjez do të vazhdojë përkrahjen e shoqatës kombëtare. Prej prezentimeve mund të fitohej pasqyrë pozitive për punën e shoqatës kombëtare në të gjitha veprimtaritë..”

Përfaqësues i Kryqit të Kuq norvegjez i cili mori pjesë në Mbledhjen e partneritetit prej 12 -14. 04. 2007 në Strugë, të organizuar prej Kryqit të Kuq të RM.



REZULTATET E PRITURA

- Janë përmirësuar kapacitetet materiale dhe kadrovike të shoqatës kombëtare
- Janë fituar njohuri dhe shkathtësi të reja për implementimin efikas të aktiviteteve programore të Kryqit të Kuq në RM.
- Është përmirësuar përgjegjësia dhe transparenca gjatë bashkëpunimit me Komitetin ndërkombëtarë të Kryqit të Kuq dhe Federatën ndërkombëtare
- Është avansuar bashkëpunimi bilateral me shoqatat kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.
- Është mbarështruar dhe avansuar bashkëpunimi i organizatave komunale të Kryqit të Kuq të RM me organizatat komunale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe nga shoqata tjera kombëtare.
- Është rritur interesi tek organizatat ndërkombëtare qeveritare dhe joqeveritare të partneritetit për përkrahje të Kryqit të Kuq të RM.
- Janë fituar përvoja dhe është edukuar numër i madh i vullnetarëve dhe të punësuarve.
- Është rritur numri i personave profesional të edukuar të gatshëm për pjesëmarrje në misione humanitare jashtë vendit.

MARKETINGU- MOBILIZIMI I FONDEVE

Kryqi i Kuq i RM në kuadër të aktiviteteve të veta planifikon aplikimin e formave të ndryshme dhe aktiviteteve për sigurimin e mjeteve materiale dhe në të holla që do të shfrytëzohen për zgjerimin dhe zhvillimin e mëtutjeshëm të aktiviteteve. Mobilizimi i fondeve paraqet parakusht të rëndësishëm për realizimin me sukses të aktiviteteve të përcaktuara programore. Në këtë drejtim sfida të madhe paraqet siguri i burimeve të qëndrueshme të fondeve. Gjithashtu do të vazhdohet me shfrytëzimin e përvojave të shoqatave dhe organizatave tjera kombëtare.

QËLLIMI KRYESOR

rritja e stabilitetit financiar dhe mbarështrimi në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme të sistemit për sigurimin e mjeteve financiare të shoqatës në nivel nacional dhe lokal.

AKTIVITETET

- Mbarështrimi i bashkëpunimit me më shumë kompani për sigurimin e mjeteve plotësuese financiare
- Promovimi i mundësive që i mundëson Ligji për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike tek partneret potencial
- Përgaditja e strategjisë për marketing dhe mobilizim të fondeve
- Përforcimi i kapacitetit të Fondit për zhvillim të Kryqit të Kuq në RM për përkrahje të organizatave komunale të Kryqit të Kuq.
- Zbatimi i anketës së opinionit publik për hulumtimin e tregut për sigurimin e fondeve për përkrahjen e projekteve
- Gjetja e mekanizmave për respektimin e Ligjit të Kryqit të Kuq të RM për realizimin e mjeteve në bazë të kompenzimeve.

REZULTATET E PRITURA

- Janë përmirësuar kapacitetet e shoqatës kombëtare nga fusha e punës financiare dhe sigurimit të mjeteve financiare
- Është përmirësuar transparenca dhe përgjegjësia para donatorëve dhe opinionit.
- Është rritur realizimi i aktiviteteve programore të Kryqit të Kuq të RM me mjete të siguruara në pajtim me Ligjin për donacione dhe sponsorime në veprimtaritë publike.



PUNA FINANSIARE – MATERIALE

Me aplikimin e procedurave finansiare afariste, Kryqi i Kuq i RM rregullon çështje shumë të rëndësishme që i përkasin aspekteve finansiare – kontabiliste të punës

Me modernizimin e mëtutjeshëm të punës materialo-finansiare, transparencën dhe përgjegjësinë në punë, do të kontribohet për funksionimin e pa penguar dhe forcimin e imazhit të shoqatës kombëtare.

QËLLIMI KRYESOR

Rritja e kapaciteteve të shoqatës kombëtare për punë bashkëkohore finansiare- materiale.

AKTIVITETET

- Përgjegjësi dhe transparencë në punën finansiare- materiale të shoqatës kombëtare.
- Veçanti në mënyrën e përgaditjes së buxhetit dhe raportit financiar të shoqatës kombëtare

AKTIVITETET PROGRAMORE:

- Modernizimi i përpunimit elektronik të shënimeve për punën materiale-finansiare nëpërmjet të lidhjes me softëare të Kryqit të Kuq të RM me organizatat komunale të Kryqit të Kuq në disa faza gjatë tërë vitit.

REZULTATET E PRITURA

- Është përmirësuar përgjegjësia dhe transparenca e shoqatës kombëtare para donatorëve dhe opinionit.
